



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor.

Emri: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë

Tel/Fax: +355 4 232 815

E-mail: info@fsdksh.com.al

Faqja e Internetit: <http://www.fsdksh.com.al>

Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt “Blerje bilete transporti ajror Vajtje-Ardhje, Tiranë-Gjenevë (Zvicër) –Tiranë, copë 1 (një)”.

Data e zhvillimit do të jetë 18.03.2019, ora 15:30, në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me të dhënat si vijon:

Blerja e 1 (një) bilete transporti ajror do të jetë Vajtje-Ardhje, Gjenevë (Zvicër) –Tiranë, economic class, me tranzit, duke përfshirë siguracionin shëndetësor për të gjithë periudhën e qëndrimit. Nisja do të bëhet më datë 20.03.2019, me tranzit në Romë (Itali) dhe kthimi nga Gjeneva më datë 22.03.2019 me tranzit në Mynih (Gjermani).

Itineraret duhet të jepen në gjuhën angleze (dhe në gjuhën shqipe nëse do të jetë e mundur), duke treguar kohën e nisjes/mbërritjes (sipas orës lokale), çmimin e kuotuar duke përfshirë tarifën + taksat dhe afatin përfundimtar për lëshimin e biletës.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor, dokumentet si më poshtë:

- Rezervimin e biletave, sipas dokumentacionit të kërkuar;
- Ekstrakti i QKR-së së Operatorit Ekonomik duhet të përfshijë objektin ose ekuivalentin e objektit të prokurimit;

- Formularin e ofertës;
- Numër llogarie në një nga bankat kryesore.

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese: Çmimi më i ulët i ofertës (i biletës së ofruar) dhe përmbushja e kërkesave specifike të orarit të axhendës së personit udhëtues.

Afati i lëvrimit/realizimit të shërbimit/punës si dhe paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar do të jetë: 2 orë nga shpallja e fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.